REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr._____ Prot Shkodër, më ____.____.2026

PROCESVERBAL
Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim

OBJEKTI I PROCEDURËS: "BLERJE PAJISJE ORENDI"

KODI/KODET PËRKATËSE NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39161000-8 – Mobilje për kopësht fëmijësh; 39713200-5 – Lavatriçe dhe tharëse rrobash; 42214100-0 – Furra gatimi.

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 167 000 (katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH.

Në mbështetje të nenit 21, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 2, pika 2, shkronja "c", si dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka hartuar këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të neneve 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe neneve 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit kërkohet si provë paraprake për deklarimin nga operatori ekonomik të përmbushjes së kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, sipas nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar.

Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, Autoriteti Kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dokumentacionin provues sipas parashikimeve të nenit 26 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar.

Sigurimi i Ofertës kërkohet në zbatim të nenit 83 të LPP-së dhe nenit 30 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar. Ky sigurim është i detyrueshëm për procedurat e prokurimit, me

përjashtim të prokurimit me vlerë të vogël, dhe përcaktohet në **masën** 2% të vlerës së përllogaritur të kontratës/fondit limit**.**

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Referuar nenit 77 të LPP-së, kërkesat për kualifikim duhet të kufizohen në ato që janë të përshtatshme, të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Në kontratat e mallrave, neni 40, pika 5, i VKM nr. 285/2021 parashikon mundësinë e kërkimit të licencave profesionale, personelit apo kapaciteteve të tjera teknike vetëm kur ato janë të nevojshme për ekzekutimin e objektit.

Duke marrë në konsideratë natyrën e kësaj kontrate, e cila ka për objekt furnizimin me pajisje dhe orendi, përfshirë pajisje elektroshtëpiake/profesionale dhe mobilie për përdorim institucional dhe nga fëmijët, Autoriteti Kontraktor nuk ka përcaktuar kërkesa shtesë për licenca profesionale, personel të licencuar apo kërkesa të tjera të kësaj natyre.

Nga natyra e mallrave objekt prokurimi nuk është evidentuar një licencë profesionale e posaçme që, sipas legjislacionit sektorial, të jetë e detyrueshme në mënyrë të përgjithshme për operatorët ekonomikë që ushtrojnë veprimtari prodhimi dhe/ose tregtimi/furnizimi të këtyre mallrave.

Mosvendosja e kërkesave shtesë është bërë në respektim të parimeve të proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës, si dhe duke mbajtur në konsideratë natyrën e procedurës së hapur të thjeshtuar, për të cilën neni 55, pika 4, i VKM nr. 285/2021 kërkon përcaktimin e kritereve të thjeshtuara të pranimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare, përkatësisht 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 1 666 800 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) lekë, që përfaqëson 40% të vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros së kërkuar në të paktën 1 (një) vit të periudhës së mësipërme.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 43, pikat 1, 2, shkronja "c", 3 dhe 6, dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Referuar nenit 43 të VKM nr. 285/2021, për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare mund të kërkohet xhiroja vjetore e realizuar për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet

e fundit financiare. Për procedurat nën kufirin e ulët monetar, vlera e xhiros minimale vjetore nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, ndërsa kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Gjithashtu, neni 55, pika 4, i VKM nr. 285/2021 parashikon që në procedurën e hapur të thjeshtuar të mbahen në konsideratë kritere të thjeshtuara pranimi dhe që kërkesat ekonomiko-financiare të jenë në raport me objektin e prokurimit; xhiroja e kërkuar nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Në rastin konkret, fondi limit është 4 167 000 lekë pa TVSH; për rrjedhojë, vlera minimale e xhiros është përcaktuar në 1 666 800 lekë, e barabartë me 40% të fondit limit.

Përcaktimi i kësaj vlere është bërë duke marrë në konsideratë natyrën dhe volumin e kontratës, e cila përfshin furnizimin me lavatriçe, soba gatimi, sete të plota shtrati për fëmijë, dollapë druri, komplete stol dhe varëse rrobash për fëmijë, si dhe krevate për çerdhe.

Kërkesa synon të krijojë siguri të arsyeshme se operatori ekonomik disponon kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për realizimin e furnizimit, pa vendosur kërkesa që tejkalojnë kufirin e përcaktuar nga legjislacioni dhe pa kufizuar në mënyrë të panevojshme konkurrencën.

Përcaktimi i periudhës 2023, 2024 dhe 2025 bazohet në tre vitet e fundit financiare të përfunduara, ndërsa përmbushja e kriterit në të paktën një nga këto vite është në përputhje me nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285/2021.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të maturuara për vitin 2026, të lëshuar nga njësia/njësitë e vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me afatet e pagesës të përcaktuara nga secila njësi e vetëqeverisjes vendore.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 76, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kërkesa synon të verifikojë përmbushjen nga operatori ekonomik të detyrimeve të maturuara për taksat dhe tarifat vendore në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në QKB, duke respektuar afatet e pagesës të përcaktuara nga secila njësi përkatëse.

Kriteri kufizohet vetëm në detyrimet e maturuara për vitin 2026 dhe nuk përfshin detyrime për të cilat afati i pagesës nuk ka përfunduar në datën e zhvillimit të procedurës.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar me sukses furnizime të ngjashme, në një vlerë totale jo më të vogël se 833 400 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind) lekë pa TVSH, që përfaqëson 20% të vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Do të konsiderohen furnizime të ngjashme furnizimet me mobilie/orendi dhe/ose pajisje elektroshtëpiake/profesionale, të ngjashme me një ose më shumë nga kategoritë e mallrave objekt prokurimi.

Për plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me një ent publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme pranohen vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 4, dhe nenit 55, pika 4, shkronja "b", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kërkesa për përvojën e mëparshme është vendosur me qëllim verifikimin se operatori ekonomik disponon përvojën teknike dhe organizative të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Për procedurën e hapur të thjeshtuar, për kontratat e mallrave, vlera totale e kërkuar për përvojën e ngjashme nuk duhet të jetë më e madhe se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe përvoja duhet të jetë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**.**

Në rastin konkret, fondi limit është 4 167 000 lekë pa TVSH; për rrjedhojë, vlera minimale e furnizimeve të ngjashme është përcaktuar në 833 400 lekë pa TVSH, e barabartë me 20% të fondit limit.

Përcaktimi si furnizime të ngjashme i furnizimeve me mobilie/orendi dhe/ose pajisje elektroshtëpiake/profesionale është bërë në lidhje me kategoritë konkrete të mallrave objekt prokurimi, pa kërkuar që operatori ekonomik të ketë realizuar më parë një kontratë identike me të gjithë artikujt e kësaj procedure.

Kriteri është përcaktuar në respektim të parimeve të proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës dhe në përputhje me natyrën e procedurës së hapur të thjeshtuar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion teknik për identifikimin dhe verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofertuara me specifikimet teknike të Autoritetit Kontraktor, për artikujt e mëposhtëm:

a. Lavatriçe për përdorim institucional: katalog teknik dhe/ose skedë teknike (datasheet) zyrtare të prodhuesit;

b. Sobë gatimi e kombinuar gaz/elektrike: katalog teknik dhe/ose skedë teknike (datasheet) zyrtare të prodhuesit.

Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë identifikimin e qartë të produktit të ofertuar dhe, kur është e aplikueshme, të përmbajë emrin e prodhuesit, modelin, kodin/referencën e produktit ose të dhëna të tjera identifikuese.

Operatori ekonomik duhet të evidentojë në dokumentacionin teknik të paraqitur karakteristikat që provojnë përputhshmërinë me kërkesat minimale të specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor.

Në rast se dokumentacioni teknik është në gjuhë të huaj, pjesët që përmbajnë informacionin e nevojshëm për verifikimin e kërkesave teknike duhet të paraqiten të përkthyera në gjuhën shqipe.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 6, shkronja "b", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Referuar nenit 40, pika 6, shkronja "b", Autoriteti Kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë fotografi apo katalogë teknikë si dëshmi për përmbushjen e kërkesave minimale të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Paraqitja e dokumentacionit teknik është kërkuar vetëm për lavatriçen dhe sobën e gatimit, pasi këto janë produkte standarde, karakteristikat funksionale dhe teknike të të cilave mund të verifikohen objektivisht nëpërmjet dokumentacionit teknik të prodhuesit.

Për lavatriçen, dokumentacioni teknik mundëson verifikimin e kapacitetit, shpejtësisë së shtrydhjes, programeve, furnizimit elektrik dhe karakteristikave të tjera funksionale. Për sobën, dokumentacioni teknik mundëson verifikimin e konfigurimit të vatrave, kapacitetit dhe funksioneve të furrës, sistemit të sigurisë së gazit, klasës së energjisë kur aplikohet dhe karakteristikave të tjera të kërkuara në specifikimet teknike.

Kërkesa nuk është shtrirë për mobiliet dhe orenditë që mund të prodhohen sipas porosisë dhe përmasave të Autoritetit Kontraktor, për të cilat katalogu standard i prodhuesit mund të mos jetë i disponueshëm ose i zbatueshëm.

Përcaktimi i dokumentacionit teknik vetëm për këto dy pajisje është bërë në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe me qëllim mundësimin e një vlerësimi objektiv të ofertës teknike, pa vendosur kërkesa të panevojshme që mund të kufizojnë konkurrencën.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin e konformitetit për pajisjet e mëposhtme:

a. Lavatriçe për përdorim institucional:
Deklaratë Konformiteti të prodhuesit dhe dokumentacion nga i cili evidentohet markimi **CE**, kur është i aplikueshëm, ose dokumentacion ekuivalent që provon përputhshmërinë me kërkesat dhe standardet e zbatueshme të përcaktuara në specifikimet teknike.

b. Sobë gatimi e kombinuar gaz/elektrike:
Deklaratë Konformiteti të prodhuesit ose dokumentacion ekuivalent që provon përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme të sigurisë elektrike dhe të pajisjeve me gaz.

Dokumentacioni i paraqitur sipas kësaj pike duhet t'i referohet produktit/modelit të identifikuar në dokumentacionin teknik të paraqitur sipas pikës **2.3.2**.

Në rast se dokumentacioni është në gjuhë të huaj, pjesët relevante për verifikimin e konformitetit duhet të paraqiten të përkthyera në gjuhën shqipe.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja "c", dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kërkesa synon verifikimin e sigurisë dhe konformitetit të lavatriçes dhe sobës së kombinuar gaz/elektrike, për të cilat, për shkak të natyrës së tyre, zbatohen kërkesa specifike të sigurisë dhe konformitetit.

Kriteri është kufizuar vetëm në këto pajisje dhe pranon dokumentacion ekuivalent, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra fizike/materiale për verifikimin e përputhshmërisë së ofertës teknike me specifikimet teknike, si më poshtë:

- **Artikulli nr. 3 – Sete të plota shtrati sipas grupmoshës:** mostër materiali drusor me përfundimin e propozuar, mostër dysheku/këllëfi dhe skicë/vizatim teknik për Tipin A dhe Tipin B;
- **Artikulli nr. 4 – Dollap druri:** mostër të materialit/përfundimit dhe të aksesorëve kryesorë;
- **Artikulli nr. 5 – Komplet stol dhe varëse rrobash për fëmijë:** mostër të materialit/përfundimit dhe të aksesorëve kryesorë;
- **Artikulli nr. 6 – Krevat për fëmijët e çerdhes, i stivueshëm: 1 (një) mostër të plotë dhe funksionale**.

Mostrat do të dorëzohen fizikisht pranë Magazinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, pranë Shkollës "Arben Broci", Shkodër, brenda afatit të fundit të përcaktuar për paraqitjen e ofertave.

Mostrat duhet të jenë të identifikuara qartë me emërtimin e operatorit ekonomik dhe numrin/emërtimin e artikullit përkatës. Për marrjen në dorëzim të mostrave do të mbahet dokumentacioni përkatës, ndërsa administrimi dhe kthimi i tyre do të kryhen në përputhje me Udhëzimin e APP nr. 03, datë 12.04.2022.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja "a", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke mbajtur në konsideratë Udhëzimin e APP nr. 03, datë 12.04.2022 për administrimin e mostrave.

Kërkesa për mostra është vendosur vetëm për artikujt për të cilët verifikimi fizik i materialit, përfundimit, përpunimit, stabilitetit dhe elementeve të sigurisë është i nevojshëm për vlerësimin e ofertës teknike.

Për artikujt nr. 3, 4 dhe 5 kërkesa është kufizuar në mostra materiali dhe aksesorësh, me qëllim shmangien e një barre të panevojshme për operatorët ekonomikë. Për artikullin nr. 6 kërkohet një mostër e plotë, për shkak të përdorimit të drejtpërdrejtë nga fëmijët dhe nevojës

për të verifikuar fizikisht stabilitetin, stivueshmërinë, sipërfaqen e shtrirjes dhe sigurinë e konstruksionit.

Për lavatriçen dhe sobën nuk kërkohen mostra fizike në fazën e ofertimit, pasi përputhshmëria e tyre verifikohet nëpërmjet dokumentacionit teknik dhe dokumentacionit të konformitetit të kërkuar në pikat 2.3.2 dhe 2.3.3.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentin **"Ofertë Teknike"**, sipas modelit të tabelës së përcaktuar më poshtë, për artikujt për të cilët kërkohet dokumentacion teknik sipas pikës **2.3.2** të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit.

Nr.	Emërtimi i produktit	Prodhuesi	Modeli/Kodi i produktit	Dokumentacioni teknik	Referenca në dokumentacion	Shënime
1	Lavatriçe për përdorim institucional					
2	Sobë gatimi e kombinuar gaz/elektrike					

Në kolonën **"Prodhuesi"** shënohet emërtimi i prodhuesit të produktit të ofertuar.

Në kolonën **"Modeli/Kodi i produktit"** shënohet modeli, kodi ose referenca identifikuese e produktit, kur është e aplikueshme.

Në kolonën **"Dokumentacioni teknik"** identifikohet katalogu, skeda teknike (datasheet) ose dokumenti tjetër teknik mbi të cilin mbështetet oferta.

Në kolonën **"Referenca në dokumentacion"** shënohet numri i faqes, kodi/referenca e produktit ose pjesa përkatëse e dokumentit ku evidentohen karakteristikat teknike të produktit të ofertuar.

Të dhënat e paraqitura në dokumentin "Ofertë Teknike" duhet të jenë në përputhje me katalogët, skedat teknike dhe dokumentacionin tjetër të paraqitur sipas kërkesave të Dokumenteve të Tenderit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 6, shkronja "b", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentit "Ofertë Teknike" është vendosur me qëllim identifikimin e qartë të produkteve të ofertuara dhe krijimin e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet produktit konkret dhe dokumentacionit teknik të paraqitur për të.

Duke qenë se për lavatriçen dhe sobën kërkohet dokumentacion teknik i prodhuesit sipas pikës 2.3.2, pasqyrimi i prodhuesit, modelit/kodit dhe referencës përkatëse në një dokument të vetëm mundëson verifikimin objektiv dhe të njëtrajtshëm të përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike.

Dokumenti "Ofertë Teknike" nuk kërkon dokumentacion teknik shtesë përtej atij të përcaktuar në pikën 2.3.2, por vetëm organizon dhe referon informacionin e paraqitur nga operatori ekonomik.

Kërkesa është kufizuar vetëm për artikujt për të cilët dokumentacioni teknik është i nevojshëm dhe, për këtë arsye, është në përpjesëtim me objektin e kontratës dhe nuk krijon barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë për garancinë, nëpërmjet së cilës të marrë përsipër se mobiliet/orenditë, lavatriçet dhe sobat e ofertuara do të mbulohen me garanci minimale 24 (njëzet e katër) muaj, për defekte prodhimi dhe funksionimi normal institucional, sipas kërkesave të specifikimeve teknike.

Për lavatriçet, operatori ekonomik duhet të deklarojë gjithashtu se gjatë periudhës së garancisë do të sigurojë shërbimin teknik/riparimin dhe pjesët e këmbimit të nevojshme për defektet që mbulohen nga garancia, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Neni 40, pika 3, kërkon që kriteret e veçanta të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me natyrën, vlerën dhe aftësinë zbatuese të kontratës, ndërsa pika 8 lejon përcaktimin e kritereve të tjera të veçanta që Autoriteti Kontraktor i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për garanci është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e mallrave objekt prokurimi dhe synon të sigurojë mbulimin e defekteve të prodhimit dhe funksionimit normal gjatë përdorimit institucional.

Përcaktimi i periudhës minimale prej 24 muajsh është në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike. Për lavatriçet, kërkesa për shërbim teknik/riparim dhe pjesë këmbimi gjatë garancisë lidhet me nevojën për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të pajisjes dhe eliminimin e defekteve të mbuluara nga garancia.

Kriteri është proporcional me objektin e kontratës dhe nuk vendos kërkesa për autorizime të posaçme nga prodhuesi apo distributori.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përgatitur mbi bazën e nevojave konkrete të Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisje dhe orendi për përdorim institucional, konkretisht lavatriçe, soba gatimi, sete të plota shtrati për fëmijë, dollapë druri, komplete stol dhe varëse rrobash për fëmijë, si dhe krevate për çerdhe.

Karakteristikat teknike të përcaktuara për secilin artikull përfaqësojnë kërkesat minimale të Autoritetit Kontraktor dhe janë hartuar duke marrë në konsideratë funksionalitetin, qëndrueshmërinë, higjienën, sigurinë dhe përshtatshmërinë e mallrave për përdorim institucional dhe, për produktet e destinuara për fëmijë, kërkesat e veçanta të sigurisë gjatë përdorimit.

Për mobiliet dhe orenditë e destinuara për përdorim nga fëmijët janë përcaktuar kërkesa minimale për materialet, stabilitetin, përpunimin dhe përfundimin e sipërfaqeve,

rrumbullakimin e skajeve dhe qosheve, shmangien e elementeve të mprehta ose pikave të rrezikshme të kapjes dhe përdorimin e materialeve të përshtatshme për ambiente ku qëndrojnë fëmijë.

Për lavatriçen dhe sobën e gatimit, parametrat teknikë janë përcaktuar në funksion të përdorimit institucional, kapacitetit, funksionalitetit dhe kërkesave të sigurisë. Për këto pajisje është parashikuar paraqitja e dokumentacionit teknik të prodhuesit, me qëllim identifikimin e produktit konkret dhe verifikimin objektiv të përputhshmërisë së tij me specifikimet teknike.

Dokumentacioni i konformitetit është kërkuar vetëm për pajisjet për të cilat verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe konformitetit është i nevojshëm dhe i zbatueshëm, duke pranuar dokumentacion ose prova ekuivalente sipas natyrës së produktit. Për lavatriçen, specifikimet teknike parashikojnë shprehimisht markimin CE dhe standardet teknike të zbatueshme ose ekuivalente.

Për mobiliet dhe orenditë që mund të prodhohen sipas porosisë së Autoritetit Kontraktor nuk është vendosur detyrim i përgjithshëm për paraqitjen e katalogëve standardë të prodhuesit, pasi një dokumentacion i tillë mund të mos jetë i disponueshëm ose i zbatueshëm.

Kërkesa për mostra është kufizuar vetëm në artikujt për të cilët verifikimi fizik i materialit, përpunimit, përfundimit, stabilitetit dhe elementeve të sigurisë është vlerësuar i nevojshëm. Për artikujt për të cilët mjafton kontrolli i materialit dhe aksesorëve janë kërkuar vetëm mostra të pjesshme, ndërsa mostra e plotë është kufizuar në produktin ku verifikimi i konstruksionit dhe sigurisë gjatë përdorimit nga fëmijët është i nevojshëm. Kjo mënyrë është zgjedhur për të shmangur një barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë.

Periudha dhe kushtet e garancisë janë përcaktuar në funksion të natyrës së mallrave dhe përdorimit të tyre institucional, me qëllim mbulimin e defekteve të prodhimit dhe funksionimit normal, sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Specifikimet teknike parashikojnë kërkesa minimale dhe lejojnë ofrimin e produkteve ekuivalente ose me karakteristika teknike më të mira, me kusht që të përmbushin funksionalitetin dhe nivelin minimal të kërkuar. Referimet ndaj standardeve teknike pranohen gjithashtu me standarde ekuivalente që provojnë nivel të barasvlershëm sigurie dhe performance. Kjo është parashikuar shprehimisht edhe në dokumentin e specifikimeve teknike.

Specifikimet teknike nuk janë hartuar me qëllim favorizimin e një marke, prodhuesi, origjine apo produkti të caktuar. Ato janë përcaktuar mbi bazën e nevojave reale të Autoritetit Kontraktor dhe në respektim të parimeve të proporcionalitetit, transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës, me qëllim sigurimin e mallrave funksionale, të qëndrueshme dhe të sigurta.